



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P.nr.761/15**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të akuzuarve M F nga V, rr. “H K” nr., A. K.nga V, rr. “L e L” nr...., R H nga fsh. S i E K-V, I. B. nga V. Rr “J. T” nr...., për shkak të veprës penale: të sulmit nga neni 187 par.2 lidhur me par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, G. H nga F Rr “T. H” nr.33, dhe F.B nga F, për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK- së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II Nr.795/2014 të datës 10.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të prokurorit të shtetit Lumturie Hoxha, dhe të akuzuarve: M.F, A.K, R.H, I.B, G.H, F.B dhe në mungesë të akuzuarve E:P dhe A.M, me datë 20.12.2017 mori dhe shpalli si dhe me datë 20.12.2017 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari M.F, i lindur me ..... në V, tani me banim në rrugën “H.K” nr., i iri i F dhe nga nëna Sh e gjinisë Dashi,....., i gjendjes ..... ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., posedues i nr. ...., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

I akuzuari A. K, i lindur me ..... në V, ku dhe banon në rrugën “L e L”, nr. ... i biri i M dhe nga nëna A e gjinisë K, i pamartuar, student, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

I akuzuari R.H, i lindur me ..... në Gj, kurse tani me banim në fshatin S i E-Komuna V, i biri i I dhe nga nëna F e gjinisë H, student, i gjendjes ..... ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

I akuzuari I.B, i lindur me ..... në V ku dhe banon në rr. "J.T" nr....., i biri i S dhe nga nëna Sh e gjinisë G, i martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

I akuzuari G. H, i lindur me ..... në F, ku dhe tani banon në rrugën "T.H" nr..., i biri i M dhe nga nëna S e gjinisë S, ka të kryer shkollën ..... i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

I akuzuari F. B, i lindur me ..... në Ferizaj, ku dhe banon në rrugën "A.B", nr....., i biri i B dhe nga nëna S e gjinisë H, i pa martuar, ka të kryer shkollën ....., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

## JANË FAJTOR

Për shkak se:

Të akuzuarit M.F, A K, R.H dhe I B:

I. Me datë 30.04.2014, rreth orës 15:55 te palestra e sporteve në Pejë, me dashje dhe në bashkëveprim përdorin forcën fizike ndaj të dëmtuarve V.TH, L.I dhe A.H që të gjithë nga F, në atë mënyrë që të pandehurit si tifoz të ekipit hendbollistit "K" nga V, të njëjtit kanë ardhur të përgatitur me shufër drurit dhe fishekzjarrë në qytetin e Pejës për të shikuar lojën e hendbollit mes ekipit te tyre dhe atij te F, me ç rast me të arritur tifozët e ekipit nga V nga ku distanca në mes tyre ishte diku 20m, ku te njëjtit shpërthejnë kordonin e sigurisë të krijuar nga polici dhe sulmojnë tifozët e Ferizajt , me ç rast disa prej tyre arrijnë qe te futen në autobusë, gjersa të dëmtuarit e sipërshënuar pësojnë lëndime të lehta trupore,

-me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, të sulmit nga neni 187 par. 2, lidhur me par. 1 dhe neni 31, të KPRK-së.

II. Me datë 30.04.2014, rreth orës 15:55 afër palestrës së sporteve në Pejë, me dashje dhe në bashkëveprim kanë dëmtuar pasurinë e luajtshme pronë e firmës "A" nga F, në atë mënyrë qe të dëmtuarit si transportues të tifozëve të F me të arritur në vendin e lartcekur hapin dyert qe tifozët të dalin mirëpo për një moment sulmohen nga tifozët e Vushtrrisë, me ç rast shoferet e autobusit-dëshmitaret I.B dhe S G me të parë sulmin mbyllë dyert dhe ulin kokën qe te ruhen nga sulmi i at qasshëm me gurë, ku si pasojë e këtij sulmi, autobusit me targa 05-935-CG, i janë thyer xhami i parë dhe i pasmë dhe dy xhamat anash, ndërsa autobusit me targa 05-180-AT, i është thyer xhami i parë, gjersa gjysma e tifozëve mbeten jashtë ku shumohen nga tifozët, edhe dëmi i shkaktuar kap vlerën prej 3.490.00 euro,

-me çka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të akuzuarit F.B dhe G.H:

Me datë 30.04.2014, rreth orës 15:55, te palestra e sporteve në Pejë, në bashkëveprim të njëjtit marrin pjesë në rrahje që kanë rezultuar me lëndime të lehtë trupor për të dëmtuarit e lartcekur, në atë mënyrë që pas sulmit që kanë pasur këtu të pandehurit nga pandehurit E. P, M.F, A.K, A.M, R.H dhe I.B, ku në mes tyre ka filluar një përleshje fizike, ashtu që të pandehurit F.B dhe G.H kanë përdorur shufra drurit duke i goditur tifozët e klubit "K", nga V, me ç rast gjatë këtij konflikti të dëmtuarit V:TH, L.I, dhe A.H kanë pësuar lëndime të lehta trupore,

-me çrast në bashkëveprim kanë kryer vepër penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par. 2 lidhur me par. 1 dhe neni 31 të KPRK-së,

Andaj, Gjykata konform nenit 41, 43 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, neni 46 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së, neni 187 par.2 lidhur me par.1 nenit 190 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarve iu shqipton :

## **DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që të akuzuarve: .....për veprën penale nga pika 1 e dispozitivit të aktakuzës, secilit veç e veç iu përcaktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3 ( tre) muajve.

Të akuzuarve: ..... për veprën penale nga pika 2 e dispozitivit të aktakuzës secilit veç e veç iu përcaktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 ( një ) muaj.

Andaj gjykata konform neni 80 par.1 dhe nenit 47 të KPK-së, të akuzuarve: .....secilit veç e veç iu shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 ( katër) muajve në të cilin dënim iu llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 30.04.2014 gjer me datën 29.05.2014 e i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarve zëvendësohet me dënim gjobe në shumë prej 400 € (katërqind euro), e të cilin dënim secili veç e veç janë të obliguar që ta paguajnë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit e lartcekur gjobën e shqiptuar nuk e paguajnë në afatin e caktuar, atëherë dënimin më gjobë gjykata do t'ia zëvendësoi secilit veç e veç me dënim burgu në kohëzgjatje 20 ditëve, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Të akuzuarit secili veç e veç obligohen që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ta paguajnë shumën prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit G.H iu përcaktua dënimi me gjobë në shumë prej 400€ (dyqind euro) në të cilin dënim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 30.04.2014 gjer me datën 29.05.2014.

Nëse i akuzuari i lartcekur gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar, atëherë gjobën gjykata do t'ia zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje 20 ditëve, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ta paguaj shumën prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Palët e dëmtuara L.I, A.H dhe B. F, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, departamenti për krime të përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II-nr.795/14 të datës 10.11.2015, kundër të akuzuarve, E.P e tj..... ,për shkak të veprave penale Të sulmit nga neni 187 par.2 lidhur me par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarve F B dhe G H, për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/II-nr.795/14 të datës 10.11.2015, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se të akuzuarit secili veç e veç e kanë kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarve iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit dhe atë secilin veç e veç për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë me ç' rast të akuzuarit kanë deklaruar secili veç e veç se i kanë kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë dhe e pranojnë fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohen dhe se ndjenë keqardhje për atë çfarë ka ndodhur ditën kritike gjatë ndeshjes henbollistike në palestrën sportive në Pejë, ku ndër të tjerat kanë deklaruar se në kohën kur i kanë kryer veprat penale ishin me moshë të rinj, janë penduar për veprimet e tyre dhe i premtuan gjykatës se veprimet e tilla nga ana e tyre nuk do të përsëritën.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve të lartcekur, meqenëse të njëjtit duke i kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa ndonjë presion, dhe ka konsideruar pranimi i fajësisë nga ana e tyre ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e secilit të akuzuar veç e veç vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarve, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, patën sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, për gjykatën nuk ka të dhëna se të njëjtit kanë ra ndesh me ligjin më parë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarit e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit dhe atë secilin veç e veç i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se këto dënime për secilin prej tyre janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do t'ju shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KRPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarin Astrit ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 463 të KPPK-së, gjykata e udhëzoi palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm,P.nr.761/15,**

Bashkëpunëtore profesionale  
Gylaj Nepola

**GJ Y Q T A R I**  
Ahmet Rexhaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.